

SOURCES OF RUSSIAN INFLUENCE IN THE BALKANS

Selim Ibraimi

South East European University in Tetovo (SEEU), N. Macedonia, selim@journalist.com

Abstract: The purpose of this paper is to identify the sources of Russian influence in the Western Balkans. The most influential and lethal tool of Russian Federation is the information warfare, composed with hybrid tactics. Moscow with tools of information warfare is attempting to put one foot in Western Balkans. Qualitative and quantitative methods were used for analysis and in final findings. The main results indicate that Russia has divers' methods to impact political developments in the Balkans. In addition, Russian Foreign Ministry has released several statements on political recent events in the Balkans. In the last five years since the wiretapping scandal which led to Nikola Gruevski's resignation and the formation of Zoran Zaev government, Russia has been interested in this part of Europe, and it engages with all interested sides in the region.

With its propaganda, Russia at least has ability to divert the policies of Western Balkan states towards EU. Moscow prefers the status of neutrality of countries that emerged from Yugoslav Federation. In other words, Kremlin challenges the U.S. on some levels and the sources of Russian influence primarily are stemming from information warfare strategies integrated in different platforms.

However, at the end of the W.W.-II, Soviet Union tried to establish the 'Balkan Federation' as a counterbalancing union against the Western Allies which had geopolitical consequences for the U.S. at that time.

Recently the EU and the U.S. have expressed their concerns on several occasions over the direction of democracy in the Balkans. Indeed Bosnia, Kosovo, Montenegro, and Macedonia remain on the edge of Russia's 'sharp knife' which has the purpose of reversing the reforms and imposing the set of regulations which favors Kremlin in the Balkans. As the paper indicate, Russia uses domestic news outlets as propaganda to reach the nations in the region and it wins the hearts of people against the Western approach to some extent. Therefore, the tendency of a perfect Russian propaganda remains a threat for the Western Balkans fragile societies. Russian strategic investments are primarily in the energy infrastructure, the oil market and the news outlet organizations around the region.

However, Russia keeps his hands open and engages with Serbia via the news organizations as 'Russia Today' and it utilizes Belgrade as a geopolitical tool to stir the unrest in Northern Kosovo. Russia and Serbia have good strategic relations which makes Russia a great power in the Balkans and as a key player.

I conclude that the Balkans remain a flashpoint for regional actors and non-state actors and the Balkans is changing according to the repositioning of global powers. The Balkan states must continue the path of reforms as only way to achieve peace and prosperity. But as paper emphasizes, Russia will continue to play crucial role in all events of Balkan politics due to the power of Russian Federation in world politics.

Keywords: Russia, Balkans, hybrid warfare, disinformation

BURIMET E INFLUENCËS RUSE NË BALLKAN

Selim Ibraimi

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë (UEJL), selim@journalist.com

Abstrakt: Qëllimi i këtij punimi është të identifikojë burimet e ndikimit rus në Ballkanin Perëndimor. Mjeti më me ndikim dhe vdekjeprurës i Federatës Ruse është lufta e informacionit, e përbërë me taktika hibride. Moska me mjete të luftës së informacionit po përpiqet të vendosë njëri-këmbë në Ballkanin Perëndimor. Metoda kualitative dhe kuantitative është përdorur për analizë dhe gjetjet përfundimtare. Rezultatet kryesore tregojnë se Rusia ka metoda të ndryshme për të ndikuar në zhvillimet politike në Ballkan. Për më tepër, Ministria e Jashtme ruse ka lëshuar disa deklarata mbi ngjarjet politike të fundit në Ballkan. Në pesë vitet e fundit që nga skandali i përgjimeve që çuan në dorëheqjen e Nikolla Gruevskit dhe formimin e qeverisë së Zoran Zaevit, Rusia është interesuar për këtë pjesë të Europës dhe ajo angazhohet politikisht me të gjitha palët e interesuara në rajon. Me propagandën e saj, Rusia së paku ka aftësinë të devijojë politikisht e shteteve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së. Moska preferon statusin e asnjësisë së vendeve që dolën nga Federata Jugosllave. Me fjalë të tjera, Kremlini sfidon Sh.B.A. në disa nivele dhe burimet e ndikimit rus kryesisht burojnë nga strategjitë e luftës së informacionit të integruara në platforma të ndryshme.

Sidoqoftë, në fund të Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik u përpoq të krijonjë 'Federatën Ballkanike' si një bashkim kundër-balancues të aleatëve Perëndimorë i cili kishte pasoja gjeopolitike për Sh.B.A në atë kohë. Kohët e

fundit BE dhe Sh.B.A. kanë shprehur shqetësimet e tyre në disa raste për drejtimin e demokracisë në Ballkan. Në të vërtetë, Bosnja, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia mbeten në skajin e 'thikës së mprehtë' të Rosisë, e cila ka si qëllim kthimin e reformave dhe imponimin e një sërë rregullash që favorizojnë Kremlinin në Ballkan. Rusia përdor media të brendshme si mjete për të arritur objektivat në rajon duke fituar 'zemrat e njerëzve' kundër metodës perëndimore në një farë mase. Prandaj, tendenca e një propagande të përsosur ruse mbetet një kërcënim për shoqëritë e brishta të Ballkanit Perëndimor. Investimet strategjike ruse janë kryesisht në infrastrukturën energetike, në tregun e naftës dhe në organizatat e lajmeve në të gjithë rajonin. Sidoqoftë, Rusia i mban duart e hapura dhe angazhohet me Serbinë përmes mediave si "Rusia Sot" dhe e shfrytëzon Beogradin si një mjet gjeopolitik për të ndezur trazirat në veri të Kosovës. Rusia dhe Serbia kanë marrëdhënie të mira strategjike që e bëjnë Rusinë një fuqi të madhe në Ballkan dhe si një lojtar kryesor. Përfundimet e hulumtimit tregojnë se Ballkani mbetet një pikë e rëndësishme për aktorët rajonale dhe aktorët jo-shtetërorë dhe se Ballkani po ndryshon në përputhje me ripozicionimin e fuqive globale. Shtetet e Ballkanit duhet të vazhdojnë rrugën e reformave si mënyrë e vetme për të arritur paqen dhe prosperitetin. Por, Rusia do të vazhdojë të luajë një rol vendimtar në të gjitha ngjarjet e politikës së Ballkanit. për shkak të fuqisë së Federatës Ruse në politikën botërore.

Fjalë kyçe: Rusia, Ballkani, lufta hibride, dezinformimi

1. HYRJE

Rusia është aktor global në marrëdhëniet ndërkombëtare duke filluar që nga shekulli i XVII kur Pjetri i Madh dhe më pas Katerina e Madhe e ngritën statusin gjeopolitik të Rosisë në shkallë ndërkombëtare. Në kohën e sotit dhe sidomos pas vitit 2000 me ardhjen në pushtet të presidentit Vladimir Putin, Rusia u bë më agresive dhe antagonistë në shkallë rajonale duke përfshirë këtu edhe Ballkanin Perëndimor. Rusia i shfrytëzon të gjitha mjetet dhe burimet për t'i përmbushur objektivat kombëtare që kanë të bëjnë me strategjinë ruse për ndikim në zonat e dikurshme të influencës ruse. Andaj kthimi i heshur i Rosisë në rajon nuk është i rastësishëm dhe ka për qëllim afatgjatë prishjen e ekuilibrave politikë, ekonomik, etnik dhe kulturorë në Ballkan. Që nga viti 2008 Federata Ruse në disa momente i arriti disa objektiva për të zbrapsur demokracinë e Ballkanit drejt reformave dhe eurointegrimi (Dursun, 2019: 124). Ndërsa Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës kërkon një reformë gjithëpërfshirëse të funksionimit të saj ose ndarjes etnike, Kosova i kërkon Uashingtonit dhe Brukselit që të mos e bëjë territorin dhe sovranitetin pjesë të marrëveshjes së re Serbi-Kosovë. Tani, Sh.B.A. duhet të mbajë së bashku shtetet e brishta si një mënyrë për të vepruar në kohë pa dërguar trupa shtesë ushtarake. "Iniciativa Ballkanike" po shkon së bashku me "Iniciativën tjetër të tre deteve" (3SI) për të parandaluar ndikimin ruso-kinez në Europën Qendrore dhe Juglindore, ndërsa Rusia me metodat hibride lirisht ka krijuar një përparësi të dukshme në Ballkan (Bardos, 2017: 9). Mjeti më i fortë rus është dezinformimi dhe shërbimet inteligjente në Ballkan.

2. MATERIALI DHE METODA

Arsyetimi për këtë studim nisët nga arsyet praktike dhe teorike të ndikimit rus në Ballkanin Perëndimor dhe reagimin amerikan gjatë kësaj periudhe të operacioneve sekrete ruse në rajon. Studimi është mbështetur në materialet e publikuara rreth problematit rus në Ballkan dhe është shfrytëzuar metoda kualitative dhe kuantitative gjegjësisht intervistat me ekspertë për të determinuar rolin rus në rajon. Ky studim ka qasje teorike empirike dhe materiali i mbledhur tregon se një epokë e re po fillon midis Fuqive të Mëdha në Ballkan (Metodiëva, 2019:14).

Nisma e re e ambasadorit amerikan në Berlin Richard Grenell ishte një hap përpara nga diplomacia europiane e dështuar e nisur nga BE në vitin 2011, e udhëhequr nga ish diplomatja e rangut të lartë, Frederica Mogherini, ku u nënshkruan më shumë se 30 marrëveshje midis Prishtinës dhe Beogradit, dhe asnjë nuk u zbatua. Por, ky moment është një rast i mirë i kthimit të Rosisë në Ballkan nëpërmes konflikteve të ngrira siç është rasti me Kosovën dhe përçarjet serbo-boshnjake. Rusia ka një diplomaci të fuqishme duke arritur që mosmarrëveshjet e pazbatuara t'i kthejë në instrument të lojës ruse në Ballkan (Jonsson, Alatalu, & Vilmer..., 2018:87).

Një rivalitet i aktorëve të jashtëm ka të ngjarë të përkeqësojë gjendjen e vështirë të tregtisë rajonale dhe humbjen e ekuilibrit të brishtë etnik në pjesët e nxehta ndëretnike të rajonit. Ndërhyrja ruse diplomatike për një marrëveshje të re shekullore në mes Kosovës dhe Serbisë, është kërcimi i ri rus në fazën e ringritjes së dialogut euroamerikan (Samorukov, 2019:11). Sipas materialit dhe gjetjeve, një ndër strategjitë kryesore të Rosisë në Ballkan mbetet ajo hibride d.m.th. një përzierje e metodave klasike dhe inteligjente ruse të trashiguara nga koha e komunizimit dhe të përsosura gjatë dy dekadave të fundit.

3. REZULTATET

Nga rezultatet e fituara mund të përfundojmë se veprimi rus ka qenë i pranishëm në Ballkan dhe në Maqedoninë Veriore. Pyetja kryesore e hulumtimit është si më poshtë. A ka pasur ndërhyrje politike dhe diplomatike në ana e Rosisë në Ballkanin Perëndimor? Nga analiza e 20 intervistave del se strategjia hibride ruse përfshinë një varg

aksionesh në disa fusha kryesore dhe mjaft të ndjeshme ku Moska arrin t'i përmbushë objektivat strategjike ruse në rajonin e Ballkanit (Secrieru, 2019:13).

Fushat e influences	2018/2019 në %	Projeksion 2020/2021
Diplomacia	10	0
Spiunazhi	10	0
Ambasada	35	0
Tubacionet energjetike	10	0
Grupet paraushtarake	10	0
Lidershipi lokal	5	0
Propaganda	15	0

4. DISKUTIME

Ndikimi i jashtëzakonshëm i Moskës në politikën lokale dhe kombëtare, qarqet mediatike dhe afariste me mbështetje nga Kisha Ortodokse Ruse, paraqet rrezik të përhershëm për rajonin dhe tani Moska është në gjendje të shkaktojë tensione etnike dhe fetare, bllokojë reformat duke mbështetur forcat radikale nacionaliste (Cohen,1994:822). Të gjitha këto janë nxitura nga mosmarrëveshjet politike, etnike dhe rivaliteti ekonomik, që bën Rusia me strategjinë “përçaj dhe sundo” (Stronski & Himes, 2019:4).

Rusia rriti masat e saj aktive në rajon, duke zbatuar më shumë faktorë joformalë në politikën e saj të deritanishme dhe përdorimin e shërbimeve sekrete. Rusia ka përdorur vazhdimisht mjetet kibernetike për të ndëshkuar, prishur dhe dezinformuar. Sulmet në shkallë të gjerë në internet janë kryer në mënyrë diskrete ose si pjesë të operacioneve komplekse hibride në kombinim me mjete të tjera shtrënguese (Prier, 2017:68).

Me sulmet kompjuterike, Rusia ka qenë veçanërisht e efektshme në arenën e informacionit psikologjik, ku narrativa ruse kanë marrë një përfundim të konsiderueshëm përmes mediave sociale. Fusha e informacionit psikologjik është thelbësore për uljen e mbështetjes për Bashkimin Europian dhe NATO-n në rajon dhe kuptohet polarizimin në rritje midis fraksioneve pro-BE-së dhe atyre pro-ruse (Vejevoda, 2017:40).

5. KONKLUZIONE

Strategjia hibride ruse, sulmet në internet dhe spiunazhi mbeten mjetet kryesore ruse në rajon. Sidoqoftë, në Ballkanin Perëndimor, dezinformimi ka qenë objektivi më i dukshëm i Rosisë. Dezinformimi dhe komunikimi strategjik kanë një ndikim tjetër që Rusia e shfrytëzon për qëllime politike. Dezinformimi dhe propaganda zbatohet përmes një numri aktorësh, përfshirë ambasadat ruse, mediat shtetërore, private dhe hakerat. Sh.B.A. ka reaguar shumë pak me mjete të drejtëpëdrejta, edhe atë vetëm me anë të diplomacisë publike, financimit të organizatave jo qeveritare dhe dhënien e fondeve për të kundërshtuar propagandën ruse në Ballkan. Sh.B.A. në Ballkan nuk mund ta kundërshtojë praninë ruse ose propagandën e Kremlinit kaq lehtë. Beteja ruse është e vështirë. andaj kërkon lojtarë të fuqishëm për të përballuar Rusinë në Ballkan.

REFERENCAT

- Bardos, G. (2017). *The Post-Cold War Balkans: Threats to Security and Stability in Southeast Europe*. *Horizons: Journal of International Relations and Sustainable Development*, (9), 224-240.
- Cohen, L. (1994). *Russia and the Balkans: Pan-Slavism, Partnership and Power*. *International Journal*, 49(4), 814-845.
- Dursun-Özkanca, O. (2019). *The Western Balkans in the Transatlantic Security Context: Where Do We Go from Here?* *Insight Turkey*, 21(2), 106-128. Retrieved August 6, 2020, from www.jstor.org/stable/26776077.
- Jonsson, O., Alatalu, S., Borogan, I., Chernenko, E., Herpig, S., Kurowska, X., . . . Vilmer, J. (2018). *Hacks, Leaks and Disruptions: Russian cyber strategies* (pp. 85-92, Rep.) European Union Institute for Security Studies (EUISS).
- Metodieva, A. (2019). German Marshall Fund of the United States.
- Prier, J. (2017). *Commanding the Trend: Social Media as Information Warfare*. *Strategic Studies Quarterly*, 11 (4), 50-85. Retrieved August 2, 2020, from www.jstor.org/stable/26271634.
- Stronski, P., & Himes, A. (2019). *Russia's Game in the Balkans* (pp. 3-4, Rep.). Carnegie Endowment for International Peace.
- Secrieru, S. (2019). (Rep.). European Union Institute for Security Studies (EUIS).
- Samorukov, M. (2019). *A Spoiler in the Balkans? Russia and the Final Resolution of the Kosovo Conflict* (pp. 10-12, Rep.). Carnegie Endowment for International Peace.

Vejvoda, I. (2017). *Resilience in the Western Balkans* (pp. 37-42, Rep.) European Union Institute for Security Studies (EUISS). Retrieved August 5, 2020, from www.jstor.org/stable/resrep07086.9.